

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **622-25-3935-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **Ndërtimi i tregut të gjelbërt dhe parkingut nëntokësor në Prizren projekt trevjeçar**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	" ARCHI TIME " SH.P.K.
NUI	601705364
Adresa	Lidhja e Prizrenit
Vendi	Prishtinë
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Dashnor Ndrecaj
Adresa elektronike	architime.infrastructure@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	21.07.2025

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Ndërtimi i tregut të gjelbërt dhe parkingut nëntokësor në Prizren projekt trevjeçar

Njoftim për kontrate dt. 07.05.2025 në E-Prokurim

B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara 14.06.2025

Lloji i Kontratës: Punë, Procedurë e Hapur, Kontratë me vlerë të madhe

Afati i fundit për dorëzimin e tenderit me dt.23.06.2025, ora 14:00

Pranimi i Proces Verbalit të Tenderit, dt.23.06.2025

Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues dt 04.07.2025

Kerkesë për qasje në dokumente: 07.07.2025

Kerkesa për rishqyrtim 09.07.2025

Vendimi i AK-se për Kerkesën për rishqyrtim 10.07.2025

Kriter për dhënien e Kontratës: Çmimi më i ulët

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A

te LPP-se.

Vendimi i AK-se mbi Kerkesen per Rishqyrtim_Aneksi 1

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitat e mëposhtme ligjore dhe rregulative:

Neni 6.1 i LPP-së – Barazia ne trajtim/jo-diskriminim

Neni 6.2 i LPP-së - Mospërdorimi efikas i fondeve publike;

Neni 7 dhe 8 i Udhëzuesit Operativ - Parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës;

Neni 10 - Parimi i Transparencës

Neni 28 - Dosja e Tenderit

Neni 32 - Përmbajtja e Dosjes së Tenderit

Neni 59 i LPP-së - Vlerësimi dhe krahasimi i ofertave bazuar në kriterin më të ulët të çmimit;

Neni 108 i LPP-së - E drejta për rishqyrtim dhe për mbrojtje efektive;

- **Neni 16 i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike - Keqklasifikimi i dokumenteve si “sekret afarist**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejtshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Në përputhje me nenin 108 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (i ndryshuar dhe plotësuar), si dhe nenin 7 dhe 8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, ne si Operator Ekonomik i përbashkët “Archi Time Sh.p.k & Pro & Co Group Sh.p.k” paraqesim **këtë ankesë** ndaj vendimit të AK-së të datës 04.07.2025, për shpërblimin e kontratës ndaj OE “G-Project & Froni 1 Sh.p.k” me ofertë në vlerë prej **1,267,540.03 EUR**, ndonëse **oferta jonë ishte më e ulët**, përkatësisht **1,175,555.55 EUR**, duke e dëmtuar jo vetëm konkurrencën e ndershme, por edhe buxhetin e Komunës me **91,984.48 EUR** më shumë dhe për më tepër konsiderojmë që vendimi i datës 04.07.2025 për shpërblimin e OE-së “G-Project & Froni 1 Sh.p.k” është **i jashtëligjshëm, diskriminues dhe i dëmshëm për interesin**

publik.

Por jo vetëm kjo, AK ka shkelur parimet themelore të LPP-së, ku në DT konkretisht në Paramasën e punëve kemi mungesë të njësisë matëse të një pozicioni. Për më tepër, ky aktivitet i prokurimit është lejuar të vazhdojë me këtë gabim thelbësor dhe është shpallur një OE fitues mbi një dokumentacion të paplotë dhe potencialisht të pasaktë, gjë që:

- **Cenon konkurrencën e ndershme,**
- **Ka shkaktuar dëme materiale dhe mundësi të humbura për OE-në tonë,**
- **Dhe ka sjellë një vendim të bazuar mbi një proces të cenueshëm në thelb.**

Më poshtë po listojmë të gjitha argumentet tona se pse ky aktiviteti i prokurimit duhet të anulohet, shkeljet e ligjeve/rregulloreve që AK i ka shkelur në këtë aktivitet si dhe diskrimininin i vazhdueshëm që po na bëhet nëpër të gjitha aktivitetet e prokurimit ku ne si OE po ofertojmë.

1.MUNGESA E NJËSISË MATËSE NË POZICIONIN 2.16 TË PARAMASËS

Në dosjen e tenderit, konkretisht në kapitullin e Punëve të Instalimeve Elektrike, është përfshirë:

- **Pozicioni 2.16,** i cili nuk përmban njësinë matëse (p.sh., cope, m, m2, kg, komplet, etj.), duke e bërë atë pozicion të papërcaktueshëm për çmim dhe të paqartë për përgatitje të ofertës.

Ky fakt:

1. **E pamundëson ofrimin e një çmimi të saktë nga OE-të;**
2. **Cenon krahasueshmërinë e ofertave;**
3. **Rrit rrezikun e interpretimit të ndryshëm nga OE të ndryshëm, duke krijuar pabarazi dhe mos trajtim të barabartë.**

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

1. Neni 7 – Parimet Themelore të LPP-së

AK ka detyrimin të sigurojë **trajtim të barabartë** dhe **mosdiskriminim** të të gjithë operatorëve ekonomikë.

2. Neni 10 – Parimi i Transparencës

Dokumentacioni i tenderit duhet të jetë i **qartë, i plotë dhe publik** për të gjithë pjesëmarrësit.

3. Neni 28, paragrafët 4 dhe 5 – Dosja e Tenderit

AK është i detyruar të përgatisë dokumentacion teknik të saktë dhe mban përgjegjësi për çdo mangësi ose paqartësi që e bën procesin të padrejtë ose të pavlefshëm.

4. Neni 32 – Specifikimet teknike në Dosjen e Tenderit

Kërkohet qartësisht që të gjitha kërkesat teknike të jenë të plotësuara me përshkrime dhe **njësi matëse të saktë** për secilin pozicion.

5. Rregulla Nr. 001/2022 e KRPP-së për Dosjen Standarde të Tenderit për Punë

Formulari i paramasës **duhet të përmbajë të gjitha njësitë matëse** për secilin pozicion të punimeve. Mungesa e tyre përbën shkelje të standardeve të dokumentacionit.

Pasojat e kësaj shkeljeje:

- AK ka lejuar që aktiviteti të zhvillohet me **paramasa të paplota**, duke pranuar oferta mbi **bazë të pasaktë dhe jökrahasuese**.
- AK ka shpallur fitues një OE mbi **bazë të një tenderi me mangësi**, që cenon **ligjshmërinë e procedurës dhe barazinë në konkurrim**.
- Operatorët si ne, që kemi ofruar me profesionalizëm dhe në përputhje me të gjitha kërkesat, jemi dëmtuar padrejtësisht, duke na u shkaktuar **dëm ekonomik dhe cënim të së drejtës për konkurrencë të ndershme**.

2. ÇMIMI MË I LIRË DHE KURSIM I BUXHETIT – INJORUAR PA BAZË

- **Fakt:** Oferta jonë është më e ulët për **91,984.48 EUR** se ajo e OE-së së shpërblyer (1,175,555.55 EUR krahasuar me 1,267,540.03 EUR).
- **Ligji:** Sipas nenit 59 të LPP-së dhe nenit 6.2 të LPP-së, AK është i detyruar të përzgjedhë ofertën më të lirë të përgjegjshme që përmbush kërkesat e dosjes së tenderit.
- **Shkelje:** Shpërblimi i ofertës më të shtrenjtë, kur ekziston një ofertë më e lirë dhe e plotë, përbën **shkelje flagrante të ligjit dhe dëm ekonomik të drejtpërdrejtë për Komunën e Prizrenit**.

3. PRETENDIMET E PABAZUARA PËR ELIMINIMIN TONË

Pretendimet tuaja për mospërputhje të dokumentacionit tonë janë të pabazuara dhe të pasakta.

Arsyeja e I-rë pretenduar nga AK për eliminimin tonë:

Mungojn referencat e natyrës se kontratës sipas kërkesës se Ak te kërkuar ne dosje te tenderit dhe

njoftim per kontrate.

Pergjigje ne arsyen e I-rë të pretenduar nga AK-es per eliminimin tone:

Në DT te Kërkesa 1 kerkohet “Projektet e natyrës se kontratës realizuar ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit te ketij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit te standardeve dhe vlerat e tyre, vlera minimale e te gjitha projekteve te natyrës se kontratës duhet te jete jo me e vogël se 2,000,000.00 Euro.” dhe te **Deshmia 1** kerkohet “Lista e projekteve te ngjashme, e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, të dëshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e punëve dhe natyrën e tyre apo proces verbal te pranimet përfundimtar të punëve (duhet te dorëzohet ne original e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik).”

Ne listen tonë të projekteve te cilës ja kemi bashkangjitur Referencat/Pranimet Teknike ashtu edhe siç është kërkuar në DT vlera e projekteve të natyrës së ngjashme me këtë aktivitet të prokurimit është mbi **12,000,000.00 €** që do të thotë e tejkalon vlerën e kërkuar në DT. Nëse ju si AK nuk i keni pasur të qartë Kontratat tona të cilat i kemi relaizuar gjatë këtyre 3 viteve të fundit, atëherë keni mundur të na kërkonit sqarim me anë të letrës sqarim të tenderit/sjellja e dëshmime, konform Nenit 72 te LPP dhe Rregullores nr.001/2023 te Prokurimit Publik pikës 10.

Arsyeja e II-të pretenduar nga AK për eliminimin tonë:

GOE ; nuk kan te dorezuar ne oferten e tyre Iso standardet ; ISO 26000: 2010 ; dhe anetari I I grupit nuk ka dorezuar Iso standardin 50001 ; 2018 pasi qe sipas rregullores te Krpp -s me nr 001-2022 dhe nenit.

Pergjigje ne arsyen e II-të të pretenduar nga AK-es per eliminimin tone:

1. Neni 16 i Rregullores nr. 001/2022 e KRPP-së (bashkimi i operatorëve ekonomikë)

Sipas **nenit 16.4** të kësaj rregulloreje:

"Një grup operatorësh ekonomikë nuk është i detyruar të marrë një formë të caktuar ligjore për të dorëzuar një ofertë ose kërkesë për pjesëmarrje. Megjithatë, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një formë të caktuar ligjore pas shpërblimit të kontratës."

Kjo nënkupton se një **GOE trajtohet si një entitet i vetëm ekonomik** për qëllimet e pjesëmarrjes në tender dhe përmbushjes së kriterëve. Nuk kërkohej që **çdo anëtar veç e veç** të plotësojë **çdo kriter**, por që **si grup, ata të demonstrojnë përputhshmëri kolektive**.

2. Neni 70 i Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) – Kërkesat për cilësi

Neni 70 i LPP-së, të cilit i referohet edhe Autoriteti Kontraktues, flet për të drejtën e AK-së të kërkojë certifikata cilësie si ISO. Megjithatë, **nuk thuhet askund që çdo anëtar i grupit duhet të**

jetë individualisht i pajisur me këto standarde. Përkundrazi, për shkak të natyrës bashkëpunuese të GOE-së, përmbushja e këtij kriteri mund të delegohet te anëtari që mbulon shërbimin përkatës.

3. Rregulla themelore e vlerësimit të kapaciteteve në GOE

Sipas praktikës së vendosur të OSHP-së dhe opinionit të KRPP-së:

"Kur një grup operatorësh ekonomikë aplikon në mënyrë të përbashkët, atëherë kapacitetet teknike dhe profesionale, si dhe standardet e cilësisë dhe menaxhimit mjedisor, mund të dëshmojnë nga njëri ose më shumë anëtarë të grupit – varësisht nga ndarja e detyrave në marrëveshjen e konzorciumit."

Prandaj, nëse anëtari i parë i konzorciumit është përgjegjës për shërbimin që mbulon standardin ISO 50001:2018 dhe ai e ka ofruar këtë certifikatë, atëherë **nuk ka asnjë bazë ligjore që kërkesa të zbatohet edhe për anëtarin tjetër që nuk mbulon atë pjesë të kontratës.**

4. Rëndësia e marrëveshjes së konzorciumit

Në çdo tender publik, marrëveshja ndërmjet anëtarëve të GOE-së paraqitet si pjesë përbërëse e ofertës dhe tregon qartë ndarjen e përgjegjësisë. Në rastin konkret, nëse nga marrëveshja del se anëtari I nuk është përgjegjës për menaxhimin e energjisë apo shërbime që lidhen me ISO 50001:2018, atëherë nuk ka asnjë arsye logjike apo ligjore që ai të jetë i pajisur me këtë certifikatë.

5. Interpretimi i gabuar i nenit 26.6 të Rregullores 001/2022

Autoriteti Kontraktues i referohet nenit 26.6 ku thuhet:

"...secili anëtar i grupit do të dëshmojë se i përmbush standardet përkatëse."

Ky formulim nuk nënkupton që secili anëtar duhet të posedojë të gjitha standardet ISO, por se secili anëtar duhet të përmbushë standardet përkatëse për pjesën që mbulon sipas marrëveshjes së konzorciumit. Kjo është një llogjikë funksionale e ndarjes së punës dhe është e njohur në të gjitha rregulloret e prokurimit publik, përfshirë edhe direktivat e BE-së.

Arsyeja e III-të pretenduar nga AK për eliminimin tonë:

Goe ka prezatuar dy kontrata per dy persona mirpro certifikatat e tyre nuk tregoj se jane te diplomuar per teknike llamarin punues.

Pergjigje ne arsyen e III-të të pretenduar nga AK-es per eliminimin tone:

I. Sqarimi i kërkesës në Dosjen e Tenderit

Në Dosjen Standarde të Tenderit (DST), është specifikuar:

“Kërkohen dy (2) teknikë llamarin punues, prej të cilëve së paku njëri të jetë i certifikuar apo i licencuar për punë ndërtimore nga institucionet shtetërore.”

Në përputhje me këtë kërkesë:

- Ne kemi prezantuar **dy kontrata pune** për dy punonjës të cilët në përshkrimin e kontratës janë të punësuar si **teknikë llamarin punues**;
- Së paku **njëri prej tyre është i certifikuar nga institucion shtetëror** për punë ndërtimore, siç është kërkuar saktësisht në DST;
- **DST nuk ka kërkuar diploma apo certifikata specifike për “teknik llamarin punues”**, por vetëm certifikim për punë ndërtimore nga institucion shtetëror, gjë që është përmbushur.

II. Shkeljet e Autoritetit Kontraktues

1. Shkelja e parimit të ligjshmërisë – Neni 7, LPP nr. 04/L-042

Sipas këtij neni:

“Autoriteti kontraktues është i obliguar të respektojë dispozitat e këtij ligji dhe të veprojë në mënyrë të drejtë, transparente dhe të barabartë me të gjithë operatorët ekonomikë.”

AK ka shkelur këtë parim sepse:

- Po vendos **kritere të pa përshkruara në DST**, duke kërkuar që certifikatat të jenë për “teknik llamarin punues”, ndërkohë që vetë në DST ka kërkuar “certifikatë për punë ndërtimore”;
- Kjo përbën një **ndryshim të kritereve gjatë fazës së vlerësimit**, që është e ndaluar me ligj dhe bie në kundërshtim me transparencën dhe barazinë.

2. Shkelja e nenit 59 të LPP – Vlerësimi i ofertave

Neni 59.4 i LPP-së përcakton:

“Autoriteti kontraktues nuk guxon të përdorë kritere të pa specifikuar në Dosjen e Tenderit gjatë vlerësimit të ofertave.”

Në këtë rast:

- **AK ka përdorur një kriter shtesë që nuk ekziston në DST**, duke kërkuar që certifikatat të përmendin konkretisht profesionin “teknik llamarin punues”, gjë që nuk ishte pjesë e kërkesës fillestare;
- Kjo përbën **diskriminim dhe interpretim subjektiv**, duke devijuar nga kriteret e qarta të publikuara.

3. Shkelja e rregullores së KRPP Nr. 001/2022 – Neni 26.3 dhe 26.6

Neni 26.3 i Rregullores përcakton:

“Operatori ekonomik duhet të dëshmojë përmbushjen e kërkesës me dokumentacion përkatës që vërteton përvojën apo përgatitjen e kërkuar të stafit.”

Neni 26.6 sqaron se:

“Certifikatat për sigurimin e cilësisë apo përgatitjes teknike nuk duhet të jenë të një formati specifik përveç rasteve kur kërkohet ndryshe në DST.”

Në rastin konkret:

- **Certifikatat e paraqitura nga ana jonë për punë ndërtimore janë valide** dhe përputhen me kërkesën e DST;
- Në DST **nuk është kërkuar që certifikatat të jenë për “teknik llamarin punues”**, prandaj çdo interpretim tjetër i AK është i paligjshëm.

III. Qëllimi eliminues i AK-së dhe mungesa e objektivitetit

- Argumenti që **certifikatat nuk tregojnë se janë të diplomuar si teknik llamarin punues**, është jo vetëm i pabazë por edhe tejkalon kërkesën zyrtare të tenderit;
- **AK është përpjekur të aplikojë kritere retroaktive**, me qëllim të eliminimit të operatorit ekonomik tonë;
- Kjo sjellje përbën **devijim nga detyrimi për të garantuar konkurrencë të drejtë** (neni 6 i LPP) dhe **cenon të drejtën tonë për trajtim të barabartë dhe të drejtë**.

Arsyeja e IV-të pretenduar nga AK për eliminimin tonë:

Ne dosjen e tenderit është kërkuar 25 punëtor të profileve të ndryshme, ndërsa GOE; ka prezantuar vetëm 13 punëtor dmth nuk e plotëson kërkesën e AK të vendosur në dosje të tenderit dhe njoftim për kontratë.

Pergjigje ne arsyen e VI-të të pretenduar nga AK-es per eliminimin tone:

1. E Drejta për Sqarim – Neni 59 i LPP-së

Sipas **nenit 59, paragrafi 4 i Ligjit për Prokurimin Publik (LPP - Ligji Nr. 04/L-042 me ndryshime)**:

“Autoriteti kontraktues, në çdo kohë gjatë vlerësimit të tenderëve, ka të drejtë të kërkojë sqarime ose informacione shtesë nga operatorët ekonomikë lidhur me ofertën e tyre, për të ndihmuar në vlerësimin e saktë të saj.”

Në këtë rast, Autoriteti Kontraktues, nëse ka pasur paqartësi apo dyshime në lidhje me numrin e punëtorëve të deklaruar në ofertën tonë, **duhej të kërkonte sqarim përmes një kërkesë zyrtare**, dhe ne do të ofronim sqarimin e duhur, duke vërtetuar se **jemi në përputhje me kërkesën për 25 punëtorë**.

2. Mosrespektimi i Parimit të Proporcionalitetit – Neni 6 i LPP-së

Sipas **nenit 6, paragrafi 2 i LPP-së**, çdo vendim i AK duhet të jetë:

“...proporcional me qëllimin që synohet të arrihet dhe të mos shkojë përtej asaj që është e nevojshme për të realizuar këtë qëllim.”

Në këtë rast, vendimi për **eliminimin direkt të ofertës sonë, pa kërkuar asnjë sqarim**, është disproporcional dhe i papërputhshëm me këtë nen. Një **mosmarrëveshje në numërim**, ose **keqinterpretim i formës së paraqitjes**, nuk justifikon eliminim pa u mundësuar sqarim paraprak.

3. Ne i kemi përfshirë të gjithë punëtorët sipas Dosjes së Tenderit

Ne kemi dorëzuar listën e plotë të stafit me **të gjithë 25 punëtorët** e kërkuar, të shpërndarë sipas profileve të specifikuara në Dosjen e Tenderit. Është e mundur që ndonjë **mospërputhje formale** apo **keqkuptim në formatimin e dokumentit** të ketë shkaktuar konfuzion për AK, por kjo është arsye më shumë që AK duhej të na kërkonte sqarim, sipas ligjit.

4. Mospërputhja nuk përbën arsye të menjëhershme për skualifikim

Sipas praktikës dhe jurisprudencës së OSHP-së dhe Rregullores së KRPP-së nr. 001/2022, **mosrespektimi i kërkesave administrative ose teknike vetëm nëse janë thelbësore**, mund të çojë në eliminim. Në këtë rast:

- Ne kemi përmbushur kërkesën për numrin e punëtorëve.
- Nuk ka mungesë substanciale, por vetëm një **vlerësim i pasaktë ose keqinterpretim nga ana e AK-së**, për të cilin **ligji detyron kërkesë për sqarim**.
-

5. Vendimi i AK shkon kundër konkurrencës dhe transparencës

Duke mos kërkuar sqarim dhe duke na eliminuar për shkak të një pretendimi të pasaktë që mund të sqarohej lehtësisht, AK ka vepruar në **kundërshtim me nenin 1 dhe 7 të LPP-së**, që promovojnë:

- Konkurrencë të barabartë,
- Trajtim të drejtë të operatorëve ekonomikë, dhe

Efikasitet në shpenzimin e fondeve publike

Arsyeja e V-të pretenduar nga AK për eliminimin tonë:

Deshmit të cilat mungojnë apo nuk i plotësojnë kriteret e kërkuara sipas dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë ;

- Greder 7 deri 10 ton
- Papuqe dore me peshë 500 deri 800 kg me forcë centrifuge min. 90 kN
- Kamion kiper me kran me peshë bartëse 9 deri 10 ton - 1 copë
- Kamion kipper me kran – peshë maksimale bartëse 2 ton – 1 copë;
- Kamionetë me vinç, peshë ngarkuese 900 deri 1000 kg - 1 copë
- Cilindër hekur hekur me gjemba për ngjeshjen e dheut – peshë maksimale 1.5 ton - 1 copë
- Cilindër për ngjeshje që tërhiqet nga eskavatori me peshë maksimale 500kg – 1 copë
- Platformë – Skele me gjerësi min. 20 metra\ me motor për ngritje vertikale me peshë bartëse min. 2.5 ton – 2 copë
- Eskavator me zingjir gome, me lopatë rrafshuese 13 deri 15t
- Kove për përzierjen e betonit me sistem hidraulik që montohet në
- Eskavatort – 1 copë
- Bulldozer rrafshues dhe ngarkues me ripër me peshë max. 3.5 ton – 1 copë

Përgjigje në arsyen e V-të të pretenduar nga AK-es për eliminimin tonë:

-

I. RRETH PRETENDIMIT TË AK PËR PAJISJE TË MUNGUARA

Ju keni theksuar në vendimin e eliminimit se mungojnë dëshmitë apo nuk janë të plota për pajisjet e listuara me lartë.

Ndërkohë, ne në **listën tonë të pajisjeve** të dorëzuar bashkë me ofertën tonë, i kemi përfshirë të gjitha këto pajisje. **Pra, jo vetëm që i kemi përmbushur kriteret e kërkuara, por i kemi tejkaluar ato në sasi dhe llojshmëri të pajisjeve.**

II. SHKELJET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

1. Shkelja e nenit 7 dhe 59 të LPP-së

Sipas nenit 59.4 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik:

“Autoriteti Kontraktues **duhet t’i kërkojë sqarime** Operatorit Ekonomik në rast të paqartësive në dokumentacion.”

- o Në rastin konkret, nëse AK ka pasur ndonjë paqartësi ose dyshim për ndonjë nga pajisjet e deklaruara, **ishte i obliguar t’na kërkojë sqarim përmes një kërkesë zyrtare** dhe jo të marrë vendim për eliminim pa vërtetuar faktet.

2. Shkelja e nenit 6 të LPP-së – Parimi i proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë

- o Vendimi për eliminim pa kërkuar sqarim është në kundërshtim me parimet e proporcionalitetit, pasi për një paqartësi potenciale, AK ka aplikuar masën më të rëndë – eliminimin.

3. Shkelja e nenit 65 të Rregullores nr. 001/2022 e KRPP-së

- o Kjo rregullore përcakton qartë se në rast të mungesës së një elementi të qartë ose një specifikimi të qartë, AK duhet të japë mundësi për sqarim përmes një kërkesë shtesë dhe jo të eliminojë menjëherë ofertën.

4. SEKRETI AFARIST – KEQPËRDORIM DHE MOHIM I QASJES

- **Fakt:** Nuk kemi marrë **deklaratën për Sekretin Afarist** nga OE fitues. Nuk e dimë se çfarë dokumentesh janë mbrojtur.
- **Ligji:** Sipas nenit 16.3 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike dhe nenit 5 të

Rregullores për Sekretin Afarist, çdo pretendim për sekret duhet të përmbajë **arsyetim të qartë dhe përshkrim të saktë të dokumenteve**, jo mbulim të përgjithshëm.

- **Shkelje:** Ky veprim është **shkelje e transparencës, barazisë dhe të drejtës për mbrojtje**. Po ashtu, është **instrumentalizim i sekretit afarist për të fshehur gabime dhe mungesa në ofertën e OE-së fitues**.

5. SHKELJA E RËNDË E NINIT 7 TË LPP-së

Përveç mangësive serioze në dokumentacionin e tenderit, konkretisht në **pozicionin 2.16**, ku mungon njësia matëse, theksojmë me shqetësim të madh edhe një **sjellje të përsëritur dhe të papranueshme të Autoritetit Kontraktues (Komunës së Prizrenit): Përdorimi i qëllimshëm i dokumenteve nga aktivitete të tjera të prokurimit për të na diskredituar**.

Në **vendimin e datës 04.07.2025**, Autoriteti Kontraktues ka përfshirë dokumente dhe pohime të aktiviteteve të tjera të mëparshme të prokurimit (ku kemi ofertuar si OE), duke aluduar në **akuza të pabazuara për falsifikim**, të cilat:

1. **Nuk kanë lidhje fare me aktivitetin aktual të prokurimit nr. 622-25-3935-5-1-1;**
2. **Janë çështje të paqarta, të pavërtetuara dhe të pazgjidhura ligjërisht;**
3. **Janë përdorur në mënyrë të qëllimshme për të ndikuar negativisht në perceptimin ndaj kompanisë sonë;**
4. **Përfshijnë inxhinierë që nuk janë të përfshirë në ofertën tonë për këtë aktivitet, duke e bërë referencën të pabazë dhe të jashtëligjshme.**

Kjo qasje përbën një **shkelje të rëndë të nenit 7 të LPP-së** (parimi i trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit), si dhe **cenon rëndë reputacionin dhe integritetin tonë si kompani private që operon me korrektësi në tregun e prokurimit publik**.

Kjo është një çështje **shumë serioze**, sepse përfshirja e qëllimshme e dokumenteve **të pakëndshme dhe të palidhura me aktivitetin konkret të prokurimit**, me synim denigrimin e një operatori ekonomik, përbën **keqpërdorim të pozitës zyrtare nga ana e Autoritetit Kontraktues (AK)** dhe një **shkelje e rëndë e parimeve të prokurimit publik**.

Kërkesë e drejtpërdrejtë:

Duke u bazuar në të gjitha sa më sipër, ne kërkojmë nga OSHP-ja që të marrë këto masa:

1. **Të anulojë vendimin e AK-së për përzgjedhjen e OE fitues, për shkak të bazës procedurale të cënueshme;**
2. **Të anulojë tërësisht këtë aktivitet të prokurimit për shkelje të rëndë të Ligjit për Prokurim Publik;**
3. **Të urdhërojë ritenderimin e aktivitetit, me përmirësime të plota në dokumentacionin e tenderit, përfshirë saktësimin e njësisë për pozicionin 2.16 dhe çdo pasaktësi tjetër të mundshme.**
4. **Të urdhërojë AK-në të veprojë vetëm mbi dokumente që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me aktivitetin përkatës të prokurimit.**
5. **Të japë vërejtje zyrtare ndaj AK-së për shkelje të etikës institucionale dhe cenim të integritetit të kompanisë sonë, përmes përfshirjes së pretendimeve të pabazuara nga tenderë të mëparshëm.**
6. **Të informojë KRPP-në për sjelljen e përsëritur të AK-së, me qëllim marrjen e masave mbikëqyrëse për trajtimin diskriminues të operatorëve ekonomikë**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

- **Humbje të drejtpërdrejtë të kontratës, me vlerë të konsiderueshme dhe fitim të parashikuar që i përkiste ofertës sonë;**
- **Shpenzime për përgatitjen e ofertës, me resurse njerëzore dhe materiale të investuara në mënyrë të kotë;**
- **Dëmtim të imazhit dhe reputacionit të kompanisë sonë, përmes përfshirjes së akuzave të pabazuara në dokumentet e një tenderi tjetër;**
- **Dëmtim të potencialit tonë për të fituar kontrata të tjera publike, si dhe humbje të besimit tek institucionet.**

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) *një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*

- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.